

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Xufe Krasniqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit P.A. nga fsh. ... K. ..., për shkak të veprave penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 par. 5 lidhur me par. 4 të KPK dhe Kanosje nga neni 185 paragrafi 4 të KPK-s, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.1381/14, të dates 09.07.2014 të cilën e përfaqësonte Prokurori Bahtije Ademi, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore dhe publike, më datën 24.11.2014, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I akuzuari P.A., nga i ati V. dhe nëna A. e lindur I., i lindur ... në ..., jeton në fshatin ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, i gjykuar, ndërsa nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

I.

Se me datën 18.06.2014 në intervalin kohor prej orës 18,00 deri në orën 18,46 minuta në rrugën R. ... në Gjilan, i pandehuri ka sulmuar- penguar personin zyrtar policin V.K. në kryerjen e detyrave zyrtare, në atë mënyrë që i pandehuri paraprakisht me një thikë në dorë kishte shkuar të lokali “ ... ” për të i qeruar hesapet me pronarin e lokalit R.R. dhe pasi nuk e gjen aty, del nga lokali për ta kërkuar të njëjtin, me këtë rast lajmërohet policia të cilët i vihen pas dhe e takojnë në rrugën te ..., e urdhërojnë që të ndalet, i pandehuri fillimisht e hedhë thikën në tokë dhe fillon që të ikë duke kaluar pengesa të njëpasnjëshme të mureve të oborreve shtëpive dhe rrethojave prej teli, dhe në momentin kur i pandehuri për shkak se has në një muri të lartë dhe në pamundësi për ta kaluar, ndalet, me këtë rast polici i cili iu kishte vu pas në ndjekje, i ofrohet dhe e urdhëron që të dorëzohet, i pandehuri nuk i përfillë urdhrin dhe gjatë tentimit për të u arrestuar i pandehuri e godet me shkelëm në këmbë, e shtyen me duar dhe e mbështet për muri policin V.K., duke i shkaktuar lëndim të lehtë trupor, në këtë moment në vend ngjarje arrin edhe dy policët tjerë N.D. dhe F.Sh., të cilët të pandehurin e rrezojnë në tokë, e prangosin dhe e vënë nën kontroll, pastaj të njëjtin e shoqërojnë në stacionin e policisë, ndërsa i dëmtuari për shkak të lëndimit të pasuar kërkon ndihmë mjekësore në emergjencën e spitalit regional në Gjilan,

- me çka ka kryer veprën penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 par. 5 lidhur me par. 4 të KPRK.

II.

Me datën 18.06.2014 në intervalin kohor nga ora 18,00 -18,46 minuta në rrugën Qarkore të lokali “ ... ” në Gjilan, i pandehuri e ka kanosur të dëmtuarin R.R., në atë mënyrë që për shkak mllefrit që kishte pas i pandehuri P.A., pas marrjes së lajmit nga vjehri i tij B.O. se me nuk është dhëndër e as punëtor i tij, i njëjti fillimisht shkon të lokali i B.O., për të biseduar për këtë çështje, dhe pasi një bisede të shkurtër i pandehuri i drejtohet me fjalë B. “ Tash unë i tregoi R. “ dhe është nisur në drejtim të lokalit “ ... M”, me një thikë në dorë hyn në lokal, fillimisht pyet ku është R. dhe pasi vëren se nuk është aty, i njëjti i drejtohet punëtorit Xh.S. me fjalë duke e porositë “ boni të fala R., në të mbyllet në shtëpi” dhe me thikë në dorë largohet nga vendi i ngjarjes dhe ikë në drejtim të pa njohur, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e ndërmarra, të i dëmtuari R.R., ka shkaktuar frikë, ankth pasiguri dhe rrezik permanent për jetë,

-me çka ka kryer vepër penale Kanosje nga neni 185 paragrafi 4 i KPRK.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 43, 45, 73, 74,75,80 dhe 83 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarin:

E G J Y K O N

Ashtu që të akuzuarit P.A., për veprën penale sipas dispozitivit **I** këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me **burg gjasht (6) muaj**, për veprën penale sipas dispozitivit **II** këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me **burg njëqind e njëzet (120) ditë**.

Në bazë të nenit 80 të KPK-s të akuzuarit i shqiptohet **denimi unik me burg në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj** i cili dënim do të ekzekutohet pasi që Aktgjykimi të merr formën e prerë.

Në bazë të nenit 83 të KPRK-s, të akuzuarit P.A., koha e kaluar në paraburgim prej 18.06.2014 deri 15.07.2014, do ti llogarit në dënimin e shqiptuar.

Në bazë të nenit 69 paragrafi 1 lidhurme nenin 62 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 të KPRK-s, të pandehurit i shqiptohet denimi plotsues **MARRJA E SENDIT-KONFISKOHET THIKA**.

Pala e dëmtuar V.K. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në contest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipsas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej tridhjetë (30) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë, PP.nr.1381/14, të datës 09.07.2014 kundër të akuzuarit P.A. nga fsh. ... K. ..., për shkak të veprave penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 par. 5 lidhur me par. 4 të KPRK-s dhe Kanosje nga neni 185 paragrafi 4 të KPK-s.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 24.11.2014, prokurori Prokurorisë Themelore në Gjilan, Bahtije Ademi, ka mbetur në tërësi pranë aktit akuzues dhe propozimeve të cilat të njëjtit i përmbajnë dhe kërkoi nga gjykata që të akuzuarin P.A. ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj sanksion penal konform dispozitave të kodit penal.

Pas fjalës përfundimtare të Prokurores gjyqtari sipas detyrës zyrtare bënë rikualifikimin e veprës penale nga pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 par. 5 lidhur me par. 4 të KPK në veprën penale sulm ndaj personit zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 par. 2 të KPRK. Pasi që sipas përshkrimit të dispozitivit të aktakuzës del se i pandehuri e ka sulmuar të dëmtuarin V.K., duke e goditur me shqelma në këmbë dhe me duar duke e mbështetur për muri.

I dëmtuari V.K. në fjalën përfundimtare deklaroi: se i bashkangjitem ndjekjes penale ndaj të akuzuarit dhe nuk paraqes kerkesë pasuroro juridike.

I akuzuari P.A., në fjalën përfundimtare deklaroi:sa i përket dispozitivit II të aktakuzës une edhe më herët e kam pranuar fajsinë për kryerjen e kësaj vepre penale dhe i kam kërkuar falje të dëmtuarit R., jam penduar dhe i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, dhe kërkoi nga gjykata që të ma shqiptoi një dënim sa ma të butë. Ndërsa sa i përket dispozitivit I të kësaj aktakuzë nuk e pranoi fajsinë se e kam sulmuar policin V. ose penguar policin, dhe kërkoi nga gjykata që të me liroi nga përgjegjësjia penale.për dispozitivin I të aktakuzës.

Pasi që i akuzuari P.A. e ka pranuar fajsinë për veprën penale sipas dispozitivit II të aktakuzës së lartë cekur, gjykata nuk i ka administruar provat për këtë rast, por vetëm për dispozitivin I të aktakuzës.

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 387 të KPPK, gjykata konstatoi këtë gjendje faktike :

- se është vërtetuar se i akuzuari P.A. nga fsh. ..., ka kryer veprat penale Sulm ndaj personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 410 paragrafi 2 dhe Kanosje nga neni 185 paragrafi 4 të KPK-s.

Këtë gjendje faktike, gjykata e konstatoi duke u bazuar në këto prova :

Raportit fillestar të incidentit me.nr ... të datës 18.06.2014;

Fotografitë e vendit të ngjarjes;

Raporti mjekësor nr. ..., të datës 18.06.2014 në emër të dëmtuarit V.K. dhe nr. ... të datës 18.06.2014.

Korpus delikti – një thikë në shkresat e lëndës

Dëshmitë e dëshmitarëve N.D., F.Sh., B.O., Xh.S. dhe G.O.

Dëshmitë e të dëmtuarëve V.K. dhe R.R..

I dëmtuari **V.K.** deklaroi: atë ditë kemi kemi shku në vendin e ngjarjes kemi takuar ankusin B.O., ai na tregoi se P. ka ardhur na ka kerrcnuar të puna, i cili ka qënë me një thikë në dorë, dhe i ka thënë B. se do të shkon të R. e ti qëroi hesapet se prej tij i kam ketë problem. Dhe ne se bashku me B. me veturë jemi vu në ndjekje të P.. Une dhe kolegu im J. i kemi thanë P. se jemi policija dhe duhet me u ndal në atë moment i njëjti e ka gjuajtur thikën në tokë dhe ka

filluar për me ikë. Duke hyrë në disa oborre të shtepive dhe duke i kaluar disa mure pas kësaj i njëjti është kthyer në drejtim timin une prap kam kërkuar nga i njëjti që të dorëzohet, dhe gjatë tentimit për të ikur i njëjti me ka shtyer dhe me ka goditur në këmbë me qrast une jam mbështetur për muri dhe kam rënë në tokë, në atë moment kanë arritur koleget e mijë F. e N. të cilët kanë arritur që ta shtinë nënë kontrollle, me këtë rast prap i njëjti ka rrezistuar dhe ka sharë, pas kësaj të njëjtin e kemi dërguar në stacionin policor ndersa une kam shkuar në emergjencë për të kërkuar ndihmë mjeksore dhe si pasojë e kësaj lëndimi Me këtë rast une nuk kam pasur thyrje por vetëm ndrydhje të këmbës së majt. Edhe në automjetin e policisë i njëjti ka bërë titur dhe ka sharë. P. une nuk e kam goditur, por lëndimet mendoj se i ka marrur gjatë kalimit të mureve.

I dëmtuari **R.R.** deklaron: Une për këtë rast e di se policija kanë ardhur të lokalet tona dhe ne ju kemi treguar drejtimin se ka ka ikur P. dhe policija se bashku me B. kanë shkuar në atë drejtim dhe une nuk di tjetër se çka ka ndodhur pastaj pasi që nuk kam qënë prezent. Prej asaj kohe P. ma nuk me është kanosur. Nese nuk e përsëritë veprën penale ndaj meje P. unë nuk do ti bashkangjitem ndjekjes penale ndaj tij dhe nuk do të paraqes kërkesë pasuroro juridike ndaj tij.

Dëshmitari **F.Sh.**, deklaron: atë ditë në rrugën Qarkore afër restaurantit “ ... ”, kemi shkuar 4 oficer e kemi marrur B. me vetur dhe jemi nisur në drejtim ka ka shkuar P., diku afër market piveve e kemi vërejtur premtimin dhe ne e kemi urdhëruar P. që të ndalet i cili ka qënë në një distancë rreth 20 metrave i njëjti ka filluar të ik dhe është futur në oborre të një shtepije pastaj e ka kaluar një pengesë prej afër 1.5 metra dhe aty e ka hudhur thikën, pas tij janë vu në ndjekje V. dhe J. ndersa une me kolegun tim jemi kthyer në vetur dhe e kemi bërë ndjekjen me veturë në një rrugicë të shkolla në kodrën e deshmoreve e kemi vërejtur V. me një afërsi me të dyshuarin, pastaj une me kolegun tim kemi dalë nga vetura dhe kemi vërejtur se i dyshuari nuk ka mundur ta kaloi këtë pengesë dhe është kthyer nga V. të cilin e ka goditur dhe e ka shtyer V. është rrezuar, ne kemi kërkuar nga i dyshuari që të ndalet dhe të dorëzohet dhe gjatë futjes nën kontrollle i njëjti ka rrezistuar dhe bërë titur, por ne kemi arritur ta prangosim dhe e kemi dërguar në Stacion. Ne me rastin e prangosjes kemi përdorë forcë proporcionale për ta prangosur.

Dëshmitari **B.O.** deklaron: P. atë ditë ka dalur duke vrapuar në drejtim të R.. Une e kam ftuar policinë për mos me ardhur deri të ndonjë e keqe, policija kanë dalur menjëherë në vendin e ngjarjes dhe P. e kemi parë në rrugë une se bashku me policinë V. dhe 2 të tjerë. Me të vërejtur P. policinë ai ka ikur duke i kaluar 3-4 mure dhe për herën tjetër policija kur e kanë takuar policija. Dhe prej atijë momenti nuk kemi patur kontakt dhe nuk na është kanosur P. nuk ka pasur thikë në dorë në momentin kur e kemi vërejtur une dhe policija, sepse une kam qënë afër 6 metra larg P..

Dëshmitari **G.O.** deklaron: une aty kam qënë në lokalim tim dhe pasi që ka ndodhur një mosmarrëveshje une P. i kam thënë që të largohet nga lokali dhe ky njëherë është larguar, dhe pas rreth një ore është kthyer prapë është nisur në drejtim të lokalit pas R., pas kësaj kanë ardhur policija në vendin e ngjarjes une nuk e di se kush e ka ftuar policinë, por policet se bashku me babin tim janë nisur në drejtim ka ka shkuar P., i cili në atë moment nuk ka qënë në vendin e ngjarjes dhe pas kësaj une nuk e di se çka ka ndodhur. P. as atë ditë e as ma vonë nuk më është kanosur mua asnjëherë.

Dëshmitari **N.D.**, deklaron: kemi dalur në vendin e ngjarjes në rrugën Qarkore afër restaurantit “ ... ”, aty kemi takuar disa persona nder ta edhe B., i cili na ka njoftuar me rastin duke e cekur se premtimi e ka sulmuar R. dhe i cili ka patur një thikë dhe na ka thënë se P. ka ikur në drejtim të vetëshërbimit P.. Une e kam parë V. sebashku me të dyshuarin dhe V. ka qënë në një pozitë sikur duke u rrezuar, por une nuk e kam parë duke e goditur P.V., ne kemi shkuar dhe e kemi prangosur të dyshuarin i cili ka rrezistuar për të prangosur duke thënë se ju pom

ndani prej të fejuara une kam qënë duke pritur një person për tna pajtuar, V. ka qënë i lënduar edhe ate në këmbë dhe ka kërkuar ndihmë mjeksore. Une në atë moment nuk kam vërejtur se ka patur lëndime dhe ne nuk kemi përdorë forc për prangosje pasi që nuk ka patur nevojë.

I akuzuari **P.A.**, gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor, e ka mohuar kryerjen e veprës penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi, duke theksuar pasi që ka ndodhur rasti më herët lidhur me kanosjen që e kam bërë, une kam shkuar tek shtëpia e B.D., që ta dërgoi B. të miqet e mijë për tu pajtuar me familjen e të fejuarës sime. Deri sa kam qënë duke e pritur B., ka ardhur një veturë e policisë por une nuk e kam ditur se janë duke me kërkuar mua. Pas kësaj une kam dalur para dyrve të oborrit dhe në atë moment është hapur dera e veturës dhe policet me kanë urdhëruar që të ndalem, por une nuk jam ndalur por kam filluar të iki pasi që kam pas qëllim separi të bisedoi me B., dhe duke vrapuar thika me ka rënë prej xhepit pasi i kam kaluar 2-3 mure policija i kam vërejtur dhe diku në ... V. ka qënë duke vrapuar pas meje ndersa policet tjer kanë qënë duke ardhur me veturë, pas kësaj une kam hyer në një sokak ku nga pas e kam pasur policin V. e përpara me ka ndalur policija me veturë mua sma muar mendja me e kalu dhe une u shtrina për toke për tu dorëzuar dhe e kam mbuluar fytyrën për të mos me lënduar fytyrën pasi që e disha qe policet do të me godasin, V. dhe policët me kanë goditur dhe me kan prangosur dhe me kanë futur në veturë, por pasi që nuk kam qënë në gjendje të jap deklaratat atëherë me kanë dërguar në emergjenc për të marrë ndihmën mjeksore. Deklaraten time nuk me kanë lejuar ta lexoi veq me kanë thënë ta nënshkruaj, me këtë rast ka qënë av. A.S..

Gjyqtari i vetëm gjykues, e vlerësoi me shumë kujdes mbrojtjen e të akuzuarit i cili e mohon kategorikisht kryerjen veprës penale sulm ndaj personit zyrtarë gjatë kryerjes se detyrave zyrtare nga neni 410 par. 2 të KPRK nga dispozitivi I duke deklaruar se nuk e ka kryer këtë sulm ndaj policit V. por i njeti ka ikur nga policia por ma vonë vullnetarisht është dorzuar dhe me këtë rast është goditur nga policët edhe pse ka qënë i shtrirë në tokë. Fakti se i akuzuari e ka kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtarë gjatë kryerjes se detyrave zyrtare sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi është vërtetuar në mënyrë shumë bindëse raporti mjekësor, dëshmitë e të dëmtuarit V.K. dhe dëshmitarëve, të cilës gjykata ja ka falur besimin e plotë, ngase janë në harmoni me njëra tjetrën.

Andaj duke u bazuar në këto prova pa asnjë mëdyshje është vërtetuar se i akuzuari P.A. e ka kryer veprën penale sulm ndaj personit zyrtarë gjatë kryerjes se detyrave zyrtare nga neni 410 par. 2 të KPRK dhe veprën penale Kanosje për të cilën e ka pranuar fajsinë.

Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues, pas administrimit të gjitha provave të lartcekura, ka ardhur në përfundim se është vërtetuar se i akuzuari është kryerës i veprave penale për të cilat akuzohet, sipas aktakuzës të lartcekur të Prokurorisë Themelore në Gjilan.

Gjyqtari i vetëm gjykues, e shpalli fajtor të akuzuarin P.A., për shkak të veprave penale sulm ndaj personit zyrtarë gjatë kryerjes se detyrave zyrtare nga neni 410 par. 2 të KPRK, dhe veprën penale Kanosje nga neni 185 paragrafi 4 të KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit P.A., gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 64 të KPK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i akuzuari për një rënë vepër penale e ka pranuar fajsinë, se i dëmtuari R.R. nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale, sjelljet e tij të mira gjatë shqyrtimit gjyqësor; se i është përgjegjur me rregull ftesave të gjykatës, ka qënë në moshë të re kur e ka kryer veprën penale, ndërsa rrethanë rënduese, gjyqtari i vetëm gjykues e ka marrë për bazë shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore nga faktin se i akuzuari veprën e ka kryer me dashje dhe pasojat e shkaktuara.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit unik me burg në kohëzgjatje prej 8 muaj, ndaj të akuzuarit P.A., është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 34 të KPK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP. kurse, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenit 463 paragrafi 2 të KPP.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 768/14, Më 23.07.2014

Sekretarja juridike,
Xufe Krasniqi

Gjyqtari
Behar Ymeri

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.